



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Plani Zhvillimor Strategjik i Ministrisë së Drejtësisë
2018-2021

Prishtinë, tetor 2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Plani Zhvillimor Strategjik i Ministrisë së Drejtësisë

2018-2021

Autor:

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës

Faqosja:

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës

E drejta e autorit:

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës

Prishtinë, tetor 2017

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	3
FJALA HYRËSE E MINISTRIT	5
HISTORIKU	6
MANDATI I MINISTRISË	7
PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË KAPACITETEVE	8
NDRYSHIMET ORGANIZATIVE DHE ADMINISTRIMI I TYRE	9
DOKUMENTET PLANIFIKUESE STRATEGJIKE NË FUQI DHE NDËRLIDHJA E TYRE ME KËTË PLAN ZHVILLIMOR	9
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	12
OBJEKTIVA E PARË STRATEGJIKE	13
PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS LIGJORE DHE INSTITUCIONALE TË SISTEMIT TË DREJTËSISË.....	13
OBJEKTIVA E DYTË STRATEGJIKE	14
AVANCIMI I NDIHMËS DHE BASHKËPUNIMIT JURIDIK NDËRKOMBËTAR	14
OBJEKTIVA E TRETË STRATEGJIKE	14
ADMINISTRIMI MË EFIKAS I SISTEMIT TË EKZEKUTIMIT TË SANKSIONEVE PENALE	14
OBJEKTIVA E KATËRT STRATEGJIKE	16
FUQIZIMI I KAPACITETEVE TË MJEKËSISË LIGJORE DHE HULUMTIMI I KRIMEVE TË LUFTËS.....	16
OBJEKTIVA E PESTË STRATEGJIKE	16
ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE PËR FUNKSIONIM EFIKAS TË SISTEMIT TË DREJTËSISË.....	16
MASAT PËR ZHVILLIM INSTITUCIONAL	18
OBJEKTIVA E PARË STRATEGJIKE.....	19
OBJEKTIVA E DYTË STRATEGJIKE	19
OBJEKTIVA E TRETË STRATEGJIKE.....	20
OBJEKTIVA E KATËRT STRATEGJIKE	20
OBJEKTIVA E PESTË STRATEGJIKE	21
ORGANIZIMI I AKTUAL DHE I ARDHSHËM I MINISTRISË	23
PLANI I VEPRIMIT	25
OBJEKTIVA E PARË STRATEGJIKE.....	25
OBJEKTIVA E DYTË STRATEGJIKE	27
OBJEKTIVA E TRETË STRATEGJIKE.....	29
OBJEKTIVA E KATËRT STRATEGJIKE	31
OBJEKTIVA E PESTË STRATEGJIKE	33

LISTA E SHKURTESAVE

AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
ASh	Avokatura Shtetërore
BE	Bashkimi Evropian
BJN	Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar
BKK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CCEJ	Komisioni Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitet në Drejtësi
DBNj	Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
DPLL	Departamenti i Profesioneve të Lira Ligjore
EULEX	Misioni i Sundimit të Ligjit në Kosovë
EUROJUST	Njësia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim Gjyqësor
IMD	Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
KASh	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njërit
KGjK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
LESP	Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administratës Publike
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBZhr	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MDA	Masat dhe Dënimet Alternative
MF	Ministria e Financave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MSh	Ministria e Shëndetësisë
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
PK	Policia e Kosovës
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
PLL	Profesionet e Lira Ligjore
PZhS	Plani Zhvillimor Strategjik
ShKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UP	Universiteti i Prishtinës
ZKM	Zyra e Kryeministrit

FJALA HYRËSE E MINISTRIT



Kjo është hera e dytë që Ministria e Drejtësisë (MD) harton një Plan Zhvillimor Strategjik për zhvillimin e sektorit të drejtësisë dhe për zbatimin e aktiviteteve që janë në funksion të objektivave dhe prioriteteve programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij Plani është të përcaktoj drejtimet e zhvillimit të sistemit të drejtësisë në periudhën 2018-2021, në mënyrë që përmbushja e obligimeve kushtetuese dhe ligjore, por edhe obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe obligimet tjera ndërkombëtare, të realizojnë avancimin e kornizës ligjore dhe institucionale në reformimin e sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës.

Për më tepër, ky plan është i orientuar për të ofruar politika publike që reflektojnë nevojat e qytetarëve të Republikës së Kosovës për një sistem të denjë dhe të besueshëm të drejtësisë. Ne kemi obligim të ndërtojmë një sistem funksional të drejtësisë, që ofron qasje efektive në drejtësi, që mbron dhe promovon të drejtat dhe liritë e themelore dhe garanton siguri juridike për subjektet e së drejtës dhe rritë besimin e qytetarëve në të.

Në fokus të këtij Plani, do të vazhdojë të mbetet, jo vetëm përgjegjësia në zbatimin e obligimeve mandatore që ndërliken me aspektet ekzekutive të fushëveprimit të Ministrisë së Drejtësisë, por edhe thellimi në ndërmarrjen e masave dhe veprimeve konkrete për jetësimin e reformës në drejtësi, duke hartuar dhe rishikuar politikat publike të fushës, në fokus të të cilave do të jenë rritja e përgjegjshmërisë, transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve zbatuese të ligjit.

Jemi të vendosur për të siguruar konsensusin e nevojshëm politik dhe shtetëror për rëndësinë e trajtimit me prioritet të lartë institucional të agjendës reformuese të sistemit të drejtësisë dhe krijimin e shtetit të së drejtës.

Lufta e pa kompromis kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, sundimi i ligjit dhe drejtësia si alternativë e vetme janë tre prioritetet themelore që do zbatohen përmes realizimit të këtij plani i cili është udhërrëfyes i punës së Ministrisë së Drejtësisë gjatë mandatit qeverisës në katër vitet e ardhshme.

Abelard TAHIRI, Ministër i Drejtësisë
Prishtinë, tetor 2017

HISTORIKU

Ministria e Drejtësisë (Ministria) u themelua më 20 dhjetor 2005, përmes Rregullores së UNMIK-ut 2005/53 që shënoi fillimin e procesit të bartjes së kompetencave nga Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut tek Ministria në një varg të fushave të caktuara.

Më 27 prill 2006, përmes Rregullores së UNMIK-ut 2006/26, Ministrisë i janë bartur edhe disa përgjegjësi shtesë.

Transferimi gradual i kompetencave dhe përgjegjësive është përcjellë edhe me transferimin e stafit vendor nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut, në Ministri të Drejtësisë si dhe kompetencave të transferuara nga EULEX-i.

Marrja graduale e kompetencave është përmbyllur duke iu përshtatur rrethanave të reja juridiko-politike pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ashtu sikurse vendet e rajonit, edhe Kosova gëzon perspektivë evropiane. Në kuadër të kësaj, Kosova është duke kaluar nëpër dy procese të rëndësishme të integritimit evropian. Në njërin anë është përmbushja e obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), ndërsa në anën tjetër është Procesi i Liberalizimit të Vizave me BE-në.

Ministria e Drejtësisë mbetet e përkushtuar në fuqizimin e vazhdueshëm të rolit të saj duke kontribuar në përmirësimin e politikave dhe legjislacionit për sektorin e drejtësisë, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të BE-së.

MANDATI I MINISTRISË

Mandati i Ministrisë mbështetet në dispozitat ligjore, përkatësisht në Nenin 18 (1) (Shtojca 1) të Rregullores së Qeverisë nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe dispozitave tjera në fuqi nga të cilat rrjedhin këto funksione dhe përgjegjësi, si në vijim:

- i. Zhvillon politikën brenda fushës së saj të përgjegjësive, mundëson përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë;
- ii. Menaxhon çështjet administrative, financiare dhe buxhetore të Ministrisë;
- iii. Ushtron mbikëqyrje ekzekutive mbi tërë shërbimin korrektues dhe shërbimin sprovues, në pajtim me dispozitat në fuqi;
- iv. Zhvillon dhe zbaton politika për të siguruar qasje të drejtë dhe efektive në sistemin e drejtësisë për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve në pajtim me ligjin në fuqi;
- v. Ushtron përgjegjësitë në kërkimin, marrjen, sigurimin dhe verifikimin e informacioneve lidhur me vendndodhjen dhe fatin e personave të zhdukur dhe kthimin e eshtrave të personave të zhdukur, shfrytëzimin e ndihmës dhe të ekspertizës së personelit përkatës, si dhe të specialistëve të tjerë, në pajtim me dispozitat në fuqi
- vi. Ushtron përgjegjësitë për çështjet që kanë të bëjnë me mjekësinë ligjore dhe hulumtimin e krimeve të luftës në pajtim me dispozitat në fuqi;
- vii. Ofron ndihmë juridike ndërkombëtare;
- viii. Përfaqëson autoritetet publike në procedurat gjyqësore dhe të arbitrazhit;
- ix. Ofron mbështetje me ekspertë në përgatitjen e marrëveshjeve të Qeverisë në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- x. Mbikëqyr sistemin e noterisë, ndërmjetësimin, përbarimit privat dhe provimin e jurisprudencës;
- xi. Ruan dhe administron pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën, apo organet tjera kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi;
- xii. Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen Ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË KAPACITETEVE

Ministria gjatë periudhës 2008-2010 ka kryer rishikimin funksional lidhur me mandatin, organizimin dhe kapacitetet e saj. I tërë procesi është mbështetur nga “Projekti i Rishikimit Funksional dhe Organizimit Institucional të Ministrive”. Në këtë kontekst janë identifikuar nevojat për ndryshime, të cilat kërkohen të bëhen me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe, në të njëjtën kohë, riorganizimin funksional të njësive organizative të Ministrisë.

Më 27 tetor 2015 Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen Stabilizim Asociim (MSA) me Bashkimin e Evropian (BE). Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi me 1 prill 2016 dhe shënon një hap të rëndësishëm në rrugën e Kosovës drejt BE-së. Zbatimi i MSA-së do të kërkojë reforma gjithëpërfshirëse ekonomike, politike dhe rendit juridik në Kosovë.

Procesi i hartimit të “Planit Zhvillimor Strategjik të Ministrisë së Drejtësisë” është ndërtuar mbi bazën e “Planit Strategjik” të kaluar që përfshinte periudhën 2012-2016 dhe i cili kishte paraparë objektivat e përgjithshme të zhvillimit të Ministrisë dhe masat konkrete për realizimin me sukses të atij plani, si dhe bazën e të gjitha dokumenteve relevante vendore dhe ndërkombëtare.

Ky Plan ka të bëjë kryesisht me strukturën, detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë. Procesi i zbatimit të këtij plani duhet të përfshijë monitorimin e ndryshimeve në infrastrukturën ligjore (primare dhe sekondare) si dhe ndryshimet tjera të specifikuara në këtë plan të veprimit për realizimin e pesë objektiveve strategjike të definuara në të.

Plani zhvillimor strategjik do të adresojë zhvillimet brenda fushë-veprimtarisë së MD-së dhe obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA). Njëra nga veprimet kryesore që reflektohet në këtë Plan Strategjik është nevoja që Ministria e Drejtësisë të përfundoj procesin e Rishikimit Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit në Kosovë.

Për të përmbushur këto objektiva, Ministria do të angazhohet për mbështetje të fuqishme politike, për ngritje të kapaciteteve profesionale për një funksionim më të mirë, për hartimin e legjislacionit në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe standardet Evropiane, për sigurim të burimeve teknike dhe financiare për udhëheqje dhe menaxhim efikas, si dhe për bashkëpunim më të mirë me partnerët tjerë, shtetet dhe organizatat ndërkombëtare.

NDRYSHIMET ORGANIZATIVE DHE ADMINISTRIMI I TYRE

Gjatë procesit të rishikimit funksional dhe gjatë hartimit të këtij Plani janë identifikuar disa fusha, në të cilat ndryshimet do të jenë të domosdoshme për të riorganizuar funksionet e Ministrisë me qëllim që të jenë në harmoni dhe funksion me strukturën organizative të saj dhe për të shtrirë kontrollin dhe përmirësuar shërbimet që ofrohen në kuadër të saj. Përmes këtij Plani Zhvillimor Strategjik do të kemi një qasje pro-aktive në procesin e planifikimit të politikave dhe legjislacionit gjithnjë në përputhje me procesin e integritimit evropian dhe rritjen e cilësisë së politikave dhe legjislacionit të MD-së në fuqizimin e mëtejshëm të sektorit të sundimit të ligjit. Këto ndryshime do të përmirësojnë sistemin e planifikimit në Ministri duke evituar fragmentimet potenciale dhe dyfishimet e mundshme ndërmjet proceseve qendrore të planifikimit të politikave me ato të Ministrisë.

DOKUMENTET PLANIFIKUESE STRATEGJIKE NË FUQI DHE NDËRLIDHJA E TYRE ME KËTË PLAN ZHVILLIMOR

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021

Ky dokument planifikues strategjik i Qeverisë së Kosovës është pikënisja kryesore për përcaktimin e objektivave në Planin Zhvillimor Strategjik të Ministrisë së Drejtësisë 2018-2021. Nga ky dokument kanë dalë edhe kornizat kryesore mbi bazën e të cilit janë vendosur edhe masat në PZhS. Njëra nga përpjekjet kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës është avancimi i kornizës ligjore në fushën penale, atë kundër korrupsionit dhe zhvillimi në rishikimin e plotë dhe funksional të sektorit të sundimit të ligjit. Më konkretisht ky dokument parasheh:

1. Rishikimin e legjislacionit të fushës penale, kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe legjislacionit për gjyqësorin dhe prokurorinë;
2. Unifikimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e të drejtave pronësore si dhe kodifikimin e legjislacionit të fushës civile;
3. Përmirësimi i kornizës ligjore për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile si dhe intensifikimi i bashkëpunimit në çështjet penale dhe civile;
4. Përmirësimi i kornizës ligjore për profesionet e lira dhe avancimi i funksionalizimit të profesioneve të lira;
5. Rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit;

6. Ngritja e nivelit të sigurisë në institucionet korrektuese si dhe parandalimi dhe luftimi i dukurive negative në institucionet korrektuese,
7. Fuqizimi i Shërbimit Sprovues për ngritjen e kapaciteteve profesionale për zbatimin e MDA¹,
8. Funksionalizimi i plotë i Avokaturës Shtetërore dhe krijimi i njësisë së veçantë për çështje të arbitrazhit;
9. Avancimi i sistemit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar dhe krijimi i fondit të veçantë nga pasuria e mbledhur;
10. Funksionalizimi i plotë i Institutit të Mjekësisë Ligjore, dhe
11. Ristrukturimi i mekanizmit të drejtësisë tranzicionale.

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit (PKZMSA)

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit është marrëveshja e parë zyrtare kontraktuale në mes të Kosovës dhe BE-së dhe njëkohësisht paraqet dokumentin kryesor nacional të politikave për aderim në BE. Kjo marrëveshje funksionalizohet në baza vjetore nëpërmjet PKZMSA, e cila vendos një kornizë gjithëpërfshirëse afatmesme të të gjitha reformave të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga MSA. PKZMSA paraqet masat dhe prioritetet për përafrimin gradual të legjislacionit vendor me *acquis*-në e BE-së përmes transpozimit të kësaj të fundit në të, si dhe për zbatimin e legjislacionit të përafruar. Plani Zhvillimor Strategjik i MD-së 2018-2021 synon të zbatoj obligimet e sektorit të drejtësisë që burojnë nga kjo marrëveshje dhe do të siguroj përputhje me PKZMSA e cila reflekton masa e prioritetet që rrjedhin nga mekanizmat politik dhe të politikave të marrëdhënieve Kosovë – BE. PKZMSA mbetet dokumenti kryesor strategjik nacional për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të të gjitha reformave të nevojshme për zbatimin e MSA-së dhe në fazat e më pastajme të aderimit në BE.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021

Kjo Strategji është një listë e prioriteteve të larta të cilat janë vendosur në këtë dokument planifikues për vendin. Ky është një dokument i cili ka për synim që t'i adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës. Krijimi i një dokumenti të tillë ka për pikënisje faktin se një prej pengesave kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit është mos-koordinimi i politikave zhvillimore dhe proceseve institucionale, të identifikuara nga studime të ndryshme të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Me këtë Strategji Kombëtare, në mes tjerash,

¹ Masat dhe dënimet alternative

parashihet edhe “fuqizimi i sistemit të drejtave pronësore dhe rritja e efikasitetit të gjykatave për zgjidhjen e rasteve”. Kontributi i Ministrisë në këtë drejtim do të jetë në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë si dhe në krijimin e politikave dhe legjislacionit për sistemin gjyqësor të Kosovës në përputhje me praktikën më të mirë të BE-së, përmes të cilit do të përmirësohet eficaenca dhe efektiviteti i gjykatave duke ulur kështu koston e proceseve për qytetarët dhe bizneset si dhe duke kontribuar kështu në krijimin e një mjedisi më të favorshëm për rritjen e investimeve të huaja në Kosovë.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2017-2019

Plani Zhvillimor Strategjik i MD-së do të jetë në përputhje me projeksionet buxhetore të Qeverisë së Republikës së Kosovës të shprehura në KASH² 2017-2019. Në kuadër të këtij dokumenti parashihet që sistemi i drejtësisë të përafrohet sa më shumë me standardet ndërkombëtare si dhe praktikën më të mirë evropiane.

² Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Ministria e Drejtësisë vazhdon me përcaktimin e objektivave dhe zbatimin e tyre brenda fushë-veprimtarisë së vet. Aktivitetet e Ministrisë së Drejtësisë reflektojnë dinamikat zhvillimore të sektorit të drejtësisë, në përputhje me agjendën evropiane. Duke u nisur nga synimet themelore të Qeverisë së Republikës së Kosovës për realizimin e reformës për një administratë publike, funksionale dhe efikase, Ministria angazhohet për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për sundimin e ligjit. Procesi i Reformës së Administratës Publike i mundëson Ministrisë që të sigurojë një strukturë organizative, mandat dhe kapacitete më efektive në shërbim të sigurimit të sundimit të ligjit për të gjithë qytetarët e vendit. Ky plan zhvillimor strategjik do të ndihmojë MD-në në përmbushjen e objektivave të saj për të ofruar shërbime sa më të mira për qytetarët e Kosovës në fushën e drejtësisë. Meqenëse institucionet e Republikës së Kosovës kanë si objektivë kryesore anëtarësimin në Bashkimin Evropian, edhe Ministria e Drejtësisë si pjesë e tyre ka marrë përsipër që të fuqizoj rolin e saj në realizimin e këtij qëllimi duke pasur për bazë pesë objektivat e saj strategjike, të cilat janë përcaktuar mbështetur në objektivat e vendosura edhe në Programin e Qeverisë 2017-2021.

Objektivat e përcaktuara nga Ministria janë si në vijim:

- 1) **Përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale të sistemit të drejtësisë;**
- 2) **Avancimi i ndihmës dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar;**
- 3) **Administrimi më efikas i sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale;**
- 4) **Fuqizimi i kapaciteteve të mjekësisë ligjore dhe drejtësisë tranzicionale; dhe**
- 5) **Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për funksionim efikas në fushën e drejtësisë.**

OBJEKTIVA E PARË STRATEGJIKE

Përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale të sistemit të drejtësisë

Ministria e Drejtësisë ka marrë përgjegjësinë e koordinimit të institucioneve të drejtësisë me qëllim të realizimit të një sërë aktiviteteve që do të krijojnë parakushte për qasje më të lehtë në drejtësi. Duke u bazuar në nevojën që Kosova të ketë Strategjinë Sektoriale për Rendin dhe Ligjin, e cila do të përcaktonte objektivat strategjike dhe zhvillimore për fushën e sundimit të ligjit, me qëllim të rritjes së efektivitetit të institucioneve shtetërore në zbatimin e ligjit si dhe përgatitjes që, në fazën e ardhshme, pas aplikimit të Kosovës për anëtarësim, të jemi sa më afër përmbushjes së kriterëve për hapjen e kapitujve negociues që janë Kapitulli 23 dhe 24, me vendim të Qeverisë do të themelohet grupi për Rishikimin Funkcional për Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë. Ky proces do të udhëhiqet nga Ministria e Drejtësisë, kurse me këtë rishikim, përveç përcaktimit të objektivave strategjike, do të synohet:

1. Që të rishikohet e tërë infrastruktura ligjore që rregullon fushën e sundimit të ligjit si dhe proceset dhe bashkëpunimin në mes të institucioneve që kanë përgjegjësi në fushën e sundimit të ligjit; dhe
2. Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve me përgjegjësi në fushën e sundimit të ligjit. Tanimë janë hartuar Termat e Referencës, të cilat do jenë referencë e diskursit dhe orientimit që duhet t'i paraprijë rishikimit të këtij sektori.

Megjithëse Ministria e Drejtësisë ka kompetenca dhe mandat të ndarë në raport me punën e prokurorisë dhe gjykatave, ne jemi të përkushtuar t'ju ofrojmë mbështetje institucionale me vendosjen e politikave sa më të mira, në mënyrë që sistemi i sundimit të ligjit në Kosovë të funksionojë në përputhje me pritjet e qytetarëve dhe normat më të avancuara demokratike. Lufta kundër korrupsionit, shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit është një proces i vështirë dhe sfidues. Në angazhimin tonë të deritanishëm, kemi marrë masat e duhura për të krijuar parakushtet ligjore dhe resurset e nevojshme për të luftuar këto dukuri.

Vëmendja e posaçme iu është kushtuar përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga raportet e Komisionit Evropian të cilat kanë theksuar se baza ligjore dhe strukturat institucionale për sistem koherent dhe të koordinuar të politikë-bërjes, përfshirë integrimin Evropian, kryesisht janë të themeluara. Megjithatë, Ministria e Drejtësisë do të vazhdojë të adresojë zhvillimet brenda fushë-veprimtarisë së saj dhe obligimeve që dalin nga MSA.

Sa i përket legjislacionit në përgjithësi, atë të fushës penale, mbi gjykatat dhe prokuroritë dhe të fushës civile, Kosova ka bërë përparime të konsiderueshme, duke hartuar dhe miratuar ligje të cilat kanë marrë për bazë praktikën e mira të vendeve të rajonit dhe vendeve të Bashkimit Evropian.

OBJEKTIVA E DYTË STRATEGJIKE

Avancimi i ndihmës dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar

Fusha e Bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtar (BJN), përpos nevojës për plotësim ndryshim të legjislacionit, përballat me sfida në monitorimin dhe respektimin e detyrimeve të Kosovës në pajtim me Marrëveshjet Dypalëshe në çështjet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar. Ministria e Drejtësisë synon të avancoj procedimin e rasteve nga ana e Prokurorive dhe Gjykatave, të përmirësoj hartimin e raporteve periodike për zbatimin e marrëveshjeve, të hartoj dhe miratoj formularë të standardizuar për shërbim të dokumenteve gjyqësore në çështje civile, të ngjashëm me formularët përkatës të Konventës së Konferencës së Hagës për përdorim nga gjykatat e Kosovës, si dhe nxjerrjen e statistikave më të detajuara.

Kjo objektive strategjike do të zhvilloj këtë fushë të rëndësishme në sektorin e sundimit të ligjit e cila do avancohet për t'iu përgjigjur kërkesave të reja në fushën e Bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtar, përfshi këtu iniciimin, negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve të reja dypalëshe për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

OBJEKTIVA E TRETË STRATEGJIKE

Administrimi më efikas i sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale

Qëllimi i Planit Zhvillimor Strategjik është të forcoj menaxhimin efektiv dhe efikas të mekanizmit të sanksioneve penale në MD, si dhe të bëjë ngritjen e kapaciteteve dhe zbatimin e praktikave më të mira të BE-së në fushën e Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues brenda strukturave përkatëse në Kosovë, sidomos duke u bazuar në të gjeturat e Raportit për Vendin të Komisionit Evropian³. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ka hyrë në fuqi nga Shtatori i vitit 2013.

³ Raporti për Vendin (Progresit) të Komisionit Evropian 2016 për Kosovën “në sistemin e burgjeve është vazhduar me Standardet Minimale të Kombeve të Bashkuara (KB) për Trajtimin e të Burgosurve dhe Rregullave Evropiane për Burgje. Ka nevojë urgjente për t’ju mundësuar të burgosurve mundësi për aktivitete dhe për punë”. Funksionalizimi i njësive ekonomike nëpër burgje dhe shtimi i masave edukative do të ndikojë në rehabilitimin dhe re-socializimin e të burgosurve. Me tepër punë pritet të bëhet në sensibilizimin e gjykatave për rritjen e numrit të rasteve të shqiptimit të dënimeve alternative (dënimin me kusht, gjysmë liria, puna në dobi të përgjithshme) për vepra më të lehta penale si dhe për funksionalizimin e monitorimit elektronik të të dënuarve”.

Ai rregullon jo vetëm ekzekutimin e sanksioneve penale përmes ShKK-së, por gjithashtu edhe sanksionet për vepra dhe masat e trajtimit të detyrueshëm, si dhe zbatimin e masave të paraburgimit.

Luftimi i favorizimit dhe korrupsionit në sistemin korrektues mbetet një sfidë në vete, andaj edukimi i vazhdueshëm dhe monitorimi i përhershëm është më se i nevojshëm. E rëndësisë së veçantë mbetet krijimi i një kodi të mirësjelljes, njësive të veçanta të trajnimit dhe metodave adekuate të hetimit.

Nga ana tjetër, Shërbimi Sprovues i Kosovës do të ofrojë ndihmë, mbrojtje, udhëzime dhe mbështetje për shkelësit dhe të dënuarit me qëllim të ri-integrimit të tyre të suksesshëm dhe ri-socializimit të tyre në shoqëri, zbatimin e masave të detyrueshme për trajtim rehabilitues për delikuentet si dhe ekzekutimin e masave dhe mbikëqyrjen e personave të dënuar apo të liruar me kusht.

Inspektorati i MD-së funksionon në bazë të LESP⁴ duke qenë mbikëqyrës i zbatimit të dispozitave ligjore në zbatim të këtij ligji. Misioni, detyrat, dhe përgjegjësitë e Inspektoratit të rregulluar me ligjin aktual do t'i nënshtrohen rishikimit funksional të sistemit të drejtësisë.

Në vitet e fundit ka një rritje të shqetësimeve rreth ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe sulmeve terroriste. Të gjitha sistemet bashkëkohore të drejtësisë penale janë duke shqyrtuar opsionet për trajtimin e luftëtarëve që marrin pjesë në luftëra të huaja, të kthyerve nga vatrat e luftës dhe ekstremistëve të tjerë me premisa të dhunës. Derisa kjo sfidë kërkon bashkërendim të të gjithë mekanizmave vendor dhe koordinim me mekanizmat ndërkombëtarë, Ministria e Drejtësisë do ta adresoj këtë në kuadër të mandatit të vet. Ndërsa Sistemi Korrektues do të avancoj programin e vet për parandalimin e radikalizimit të burgosurve të tjerë, të cilët mund të jenë në kontakt me të kthyerit nga vatrat e luftës ose persona të tjerë të radikalizuar.

Bazuar në pritshmërinë se numri i të burgosurve do të rritet për shkak të ri-pranimeve nga shtetet e tjera, Kosova ka ndërtuar kapacitete të reja infrastrukturore në ShKK dhe ka rindërtuar ato ekzistueset. Deri më tash, kapacitetet profesionale të stafit të Shërbimit Korrektues dhe Sprovues janë rritur dhe, në të njëjtën kohë, janë ndërmarrë masat për ri-socializimin e të burgosurve. Gjithashtu, janë themeluar institucione të veçanta për ekzekutimin e masave edukative për të miturit në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

⁴ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale

OBJEKTIVA E KATËRT STRATEGJIKE

Fuqizimi i kapaciteteve të mjekësisë ligjore dhe hulumtimi i krimeve të luftës

Fuqizimi i mekanizmave të mjekësisë ligjore në vend rrjedhin nga nevojat e identifikuar gjatë funksionimit të Institutit, si dhe të gjeturat e raporteve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Fusha e mjekësisë ligjore do të avancohet dhe mbështetet më tutje me legjislacionin primar dhe sekondar, përmes të cilit synohet rritja e cilësisë së shërbimeve për trajtimin e rasteve. Menaxhimi dhe mirëmbajtja me sukses e sistemit mjeko-ligjor, do të bëhet bazuar në standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira Evropiane për të siguruar shërbime mjeko-ligjore. Për shërbime më të mira mjeko-ligjore dhe rritje të kapaciteteve të veta, Instituti do të bashkëpunoj dhe lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institute simotra relevante ndërkombëtare.

Shërbimet mjeko-ligjore të vazhdojnë kontributin e tyre duke rritur efikasitetin e Gjykatave në përmbarimin e lëndëve duke marrë pjesë në dhënien e mendimit rreth ekspertizave mjeko-ligjore.

Me qëllim të lehtësimit të punës lidhur më identifikimin e personave të pagjetur dhe zhvillimit normal të procesit të kompensimit e viktimave të krimit, MD planifikon ristrukturimin mekanizmit për hulumtimin e krimeve të luftës përmes krijimit të Departamentit për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit me synim kujdesin dhe kompensimin e viktimave me theks të veçantë ndaj viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

OBJEKTIVA E PESTË STRATEGJIKE

Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për funksionim efikas të sistemit të drejtësisë

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (AAPSK) ka rritur kapacitetet e saj njerëzore dhe teknike për t'iu përgjigjur kërkesave ligjore dhe operacionale sa i përket administrimit të pasurisë së paligjshme të sekuestruar dhe konfiskuar.

Megjithatë, për shkak të rritjes së numrit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, ndjehet nevoja për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore në AAPSK në përgjithësi, dhe në procedurat e pranimit, vlerësimit, ruajtjes së vlerës dhe shitjes në veçanti.

Profesionet e Lira Ligjore (PLL-të) janë një nga elementet me rëndësi për një gjyqësor efikas të sistemit të drejtësisë. Ky është standard i pranuar në nivel të BE-së, si dhe derivat i një numri të

rekomandimeve të Këshillit të Evropës, udhëzimeve të CEPEJ⁵, gjithashtu opinionet e CCEJ⁶, dhe institucioneve tjera relevante dhe të vlefshme për efikasitetin e gjyqësorit në funksion të Sundimit të Ligjit. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Karta e BE-së për të drejtat themelore dhe standarde tjera ndërkombëtare dhe Evropiane në lidhje me sundimin e ligjit, janë po ashtu të aplikueshme për PLL-të.

Rëndësia e **Departamentit për Profesione të Lira Ligjore (DPLL)** në MD dhe roli i tij është thelbësor për përforcimin e Sundimit të Ligjit kryesisht për shkak të aspekteve si në vijim:

1. Departamenti mbikëqyr aktivitetet e PLL. Të gjithë anëtarët e PLL-ve kryejnë detyra me interes publik;
2. Funksionimi siç duhet i PLL-ve, për të cilat ky Departament është përgjegjës, konsiderohet parakusht për lehtësimin e gjyqësorit, avancimin dhe e efikasitetin e tij dhe përforcimin e sundimit të ligjit.

Vështirësitë në funksionimin e **Avokaturës Shtetërore (ASH)** flasin për raste të shumta të grumbulluara pranë këtij organi në raport me numrin e vogël të avokatëve që veprojnë në kuadër të tij. Si rrjedhojë, Ministria e Drejtësisë ka paraparë adresimin me prioritet të nevojave për konsolidimin e mëtejme dhe ngritjen e profesionalizmit dhe të kapaciteteve funksionale të ASH.

Në mënyrë që të adresohen të gjeturat e **Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB)**, Ministria e Drejtësisë, në kuadër të masave të mbikëqyrjes dhe kontrollit, do të vazhdojë të rrisë kontrollin e brendshëm për të kontribuar në menaxhimin sa më efikas të parasë publike, përfshirë, *inter alia*, procedurat e prokurimit, menaxhimin e pasurisë, menaxhimin e personelit, të hyrat, buxhetin dhe shpenzimet në nivel të Ministrisë.

⁵ Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë

⁶ Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë

MASAT PËR ZHVILLIM INSTITUCIONAL

Me qëllim të përmbushjes së objektivave strategjike, Agjendës Evropiane e cila kryesisht rrjedh nga obligimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), Ministria konsideron të nevojshme të adresoj zbrazëtitat aktuale në kapacitetet e burimeve njerëzore dhe rregullimin e brendshëm struktural. Menaxhmenti i Ministrisë, duke u bazuar në analizat të dala nga procesi Reformës së Administratës Publike si dhe shkallës së përmbushjes së detyrimeve që derivojnë nga masat e Planit paraprak Zhvillimor të Ministrisë së Drejtësisë, ka identifikuar një numër masash që duhet ndërmarrë. Hartimi i këtij Plani Zhvillimor Strategjik përcakton një varg masash të nevojshme që mundësojnë realizimin e secilës objektivë strategjike të paraqitur si në vijim.

Ky plan strategjik do të ofrojë orientimet e nevojshme për objektivat, masat dhe aktivitetet e MD-së për zhvillimin e mëtutjeshëm të saj në mënyrë që të përmbush mandatin e saj të përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, ky Plan Zhvillimor do të ndihmojë komunitetin e partnerëve/donatorëve, dhe aktorëve tjerë relevant ndërkombëtarë, me qëllim të rritjes së efektit të kontributeve të tyre drejt avancimit të reformave në sistemin e drejtësisë. Në anën tjetër, PZhS do të garantoj koherencë dhe menaxhim me efikasitet të proceseve strategjike mbi planifikimin dhe orientimin e ndihmës së jashtme në prioritetet e përcaktuara nga MD. Ky plan po ashtu synon të rrisë bashkëpunimin me Shoqërinë Civile dhe grupet e interesit për rritje të transparencës dhe llogaridhënies në hartimin dhe zbatimin e politikave.

OBJEKTIVA E PARË STRATEGJIKE

Përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale të sistemit të drejtësisë

Ministria ushtron funksione dhe është kompetente në hartimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë konform detyrave dhe përgjegjësisë ligjore. Me qëllim të realizimit të procesit të rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit, zhvillimit të politikave legjislative, hartimit dhe zbatimit të ligjeve, Ministria do të merr këto masa në përmbushjen e kësaj objektivë strategjike:

- Masa 1.1** Rishikimi Funksional i sektorit të sundimit të ligjit;
- Masa 1.2** Rishikimi i legjislacionit të fushës penale, kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe legjislacionit për gjyqësorin dhe prokurorinë;
- Masa 1.3** Unifikimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e të drejtave pronësore si dhe kodifikimin e legjislacionit të fushës civile;

OBJEKTIVA E DYTË STRATEGJIKE

Avancimi i ndihmës dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar

Ministria, me qëllim të përmbushjes së mandatit të saj ligjor dhe obligimeve ndërkombëtare, sa i përket fushës së bashkëpunimit juridik ndërkombëtar do të ndërmerr veprimet e më poshtme:

- Masa 2.1** Përmirësimi i kornizës ligjore për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile;
- Masa 2.2** Intensifikimi i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile dhe penale;
- Masa 2.3** Lidhja e marrëveshjeve të reja dypalëshe dhe aderimi në mekanizma rajonal dhe ndërkombëtarë;
- Masa 2.4** Ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit të DBJN, dhe aktorëve tjerë relevant
- Masa 2.5** Digjitalizimi i Arkivës në DBJN-së;

OBJEKTIVA E TRETË STRATEGJIKE

Administrimi më efikas i sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale

Plani Zhvillimor Strategjik synon menaxhimin efektiv dhe efikas të mekanizmit të sanksioneve penale në MD, si dhe ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe zbatimin e praktikave më të mira të BE-së në fushën e Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues brenda strukturave përkatëse në Kosovë. Gjithashtu, përmes kësaj objektive, synohet që të fuqizohet mekanizmi për mbikëqyrjen e punës së ShKK-së përmes fuqizimit të Inspektoratit të MD-së për SHKK-në.

- Masa 3.1** Ngritja e nivelit të sigurisë në institucionet korrektuese si dhe parandalimi dhe luftimi i dukurive negative në Institucionet Korrektuese;
- Masa 3.2** Ngritja e kapaciteteve teknike, profesionale të personelit të Institucionet Korrektuese për trajtimin e të burgosurve në përputhje me instrumentet ndërkombëtare;
- Masa 3.3** Fuqizimi i Shërbimit Sprovues për ngritjen e kapaciteteve profesionale për zbatimin e Masave dhe Dënimeve Alternative;
- Masa 3.4** Fuqizimi i Inspektoratit të MD-se për SHKK-në

OBJEKTIVA E KATËRT STRATEGJIKE

Fuqizimi i kapaciteteve të mjekësisë ligjore dhe hulumtimi i krimeve të luftës

Fuqizimi i kapaciteteve të mjekësisë ligjore dhe drejtësisë tranzicionale paraqet një hap të rëndësishëm dhe të nevojshëm për të përkrahur autoritetet vendore në forcimin e sundimit të ligjit, për një sistem gjyqësor transparent me fokus të veçantë në shërbimet e Mjekësisë Ligjore. Duke konsideruar që është fushëveprim që përfshinë sektorë dhe aktorë tjerë, para së gjithash PZhS i MD-së, do të përmirësoj kapacitetet e Institutit të Mjekësisë ligjore në ushtrimin e të drejtave të njeriut, e gjithashtu përmirësoj bashkëpunimin në mes të gjitha strukturave të drejtësisë me komunitetin, si ato gjyqësore dhe ato forenzike.

Me themelimin e Departamentit të ri për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit synohet që të rregullohen, përmes politikave dhe ndryshimeve eventuale ligjore, çështjet që kanë të bëjnë me fushën e drejtësisë tranzicionale, ofrimin e mbështetjes në mbledhjen dhe dokumentimin e fakteve që kanë të bëjnë me krimet e luftës të kryera në Kosovë, mbështetje në

identifikimin, dokumentimin dhe vlerësimin e dëmeve të luftës, shqyrtimin e kërkesave të pranuar nga viktimat e krimit për kompensim, ofrimin e mbështetjes së nevojshme administrative dhe teknike komisionit për kompensimin e viktimave të krimit, etj. Masat konkrete të cilat janë propozuar të i rregullojnë këto fusha janë:

- Masa 4.1** Funkcionalizimi i plotë i Institutit të Mjekësisë Ligjore;
- Masa 4.2** Ngritja e kapaciteteve profesionale në fushën e Mjekësisë Ligjore;
- Masa 4.3** Avancimi i shërbimeve laboratorike mjekoligjore;
- Masa 4.4** Rritja e efikasitetit në trajtimin e rasteve të personave të pagjetur;
- Masa 4.5** Fuqizimi i bashkëpunimit në fushën e mjekësisë ligjore;
- Masa 4.6** Ristrukturimi i mekanizmit për hulumtimin e krimeve të luftës;

OBJEKTIVA E PESTË STRATEGJIKE

Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për funksionim efikas në fushën e drejtësisë

Fuqizimi dhe funksionalizimi i **Avokaturës Shtetërore** është prioritet në periudhën vijuese. Krahas rritjes së nivelit të performancës për përfaqësimin e institucioneve shtetërore nga ana e Avokaturës Shtetërore, do të zhvillohet dhe zgjerohet edhe me përfaqësimin në procedurën e arbitrazhit, e cila duhet të kryhet me kompetencë dhe resurse të mjaftueshme humane.

Fillimisht këto iniciativa do të ndërmerren me nisjen e hartimit të një dokumenti konceptual për Avokaturën shtetërore i cili do të ofron opsionin adekuat për fuqizimin e këtij mekanizmi.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (AAPSK) do të zhvillohet në vazhdimësi duke përmirësuar kapacitetet e saja, përfshirë zgjerimin e depove ekzistuese dhe krijimin e hapësirave të reja, rritjen e kapaciteteve funksionale, në përforcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me gjykata, prokurori e institucione tjera, etj.

Duke qenë se **Profesionet e Lira** janë një fushë e re në sektorin e drejtësisë, nevoja për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve është evidente për mirë-funksionimin e tyre si dhe fuqizimin e mekanizmave të MD-së për licencimin dhe monitorim tyre, si dhe rritjen e cilësisë së trajnimeve për Profesionet e Lira. Një fokus specifik do të vihet në monitorimin e perceptimit të publikut për Profesionet e Lira dhe përkufizimi i politikave të MD-së në fushat relevante, si dhe në trajnimin e stafit të departamentit dhe futjen/përmirësimin e bazave të të dhënave në MD për profesionet e lira


ligjore. Gjithashtu, me këtë PZhS parashihet krijimi i një divizioni të ri në kuadër të Departamentit për Profesione të Lira “Divizioni për mbikëqyrje administrative dhe mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së Profesioneve të Lira”.

Masat e mëposhtme janë paraparë që të rregullohen çështjet që ndërlidhen me institucionet e lartpërmendura.

- Masa 5.1** Funkcionalizimi i plotë i Avokaturës Shtetërore dhe krijimi i njësisë së veçantë për çështje të arbitrazhit;
- Masa 5.2** Avancimi i sistemit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar;
- Masa 5.3** Forcimi i mekanizmit mbikëqyrjes së profesioneve të lira me qëllim të funksionimit të mirëfilltë të mbikëqyrjes së profesioneve të lira;
- Masa 5.4** Përmirësimi i kornizës ligjore për profesionet e lira dhe avancimi i funksionalizimit të profesioneve të lira;

Organizimi i ardhshëm i Ministrisë së Drejtësisë

SKEMA ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË MINISTRISË SË DREJTËSISË



PLANI I VEPRIMIT

OBJEKTIVA E PARË STRATEGJIKE

Përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale të sistemit të drejtësisë

Masa 1.1		Rishikimi Funkcional i sektorit të sundimit të ligjit			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Hartimi i Termave të Referencës për analizën gjithëpërfshirëse	2018	Kabineti, DIEKP	ZKM, MF, MPB, KGJK, KPK, AKI, PK, Dogana	23,000 BKK 20,000 (Donacion Ambasada Amerikane)
2	Përgatitja e analizës lidhur me sektorin e drejtësisë	2019	Kabineti, DIEKP	ZKM, MF, MPB, KGJK, KPK, AKI, PK, Dogana	BKK dhe partnerët ndërkombëtarë
3	Përmirësimi i Infrastrukturës ligjore që rregullon fushën e drejtësisë duke u bazuar në analizën lidhur me sektorin	2020 - 21	Kabineti, DIEKP, DL	ZKM, MF, MPB, KGJK, KPK, AKI, PK, Dogana	BKK dhe partnerët ndërkombëtarë
4	Raporti mbi vlerësimin të kapaciteteve të institucioneve me përgjegjësi në fushën e drejtësisë	2019	Kabineti, DIEKP	ZKM, MF, MPB, KGJK, KPK, AKI, PK, Dogana	BKK dhe partnerët ndërkombëtarë
5	Hartimi i Strategjisë për Sektorin e Drejtësisë	2020 -21	Kabineti, DIEKP	ZKM, MF, MPB, KGJK, KPK, AKI, PK, Dogana	BKK dhe partnerët ndërkombëtarë

Masa 1.2		Rishikimi i legjislacionit në fushën penale, kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe legjislacionit për gjyqësorin dhe prokurorinë			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Hartimi i legjislacionit në fushën penale	2018	DL	ZKM, KGJK, KPK, MPB, PK,	BKK dhe Partneret/donatorët e huaj

				Dogana, AKK	
2	Hartimi i legjislacionit në fushën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit	2018	DL	ZKM, MF, KPK, MPB, PK, AKK	BKK dhe Partneret/donatorët e huaj
3	Hartimi i legjislacionit për gjyqësorin dhe prokurorinë	2018	DL	ZKM, KGJK, KPK, Akademia e Drejtësisë	BKK dhe Partneret/donatorët e huaj

Masa 1.3		Unifikimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e të drejtave pronësore si dhe kodifikimin e legjislacionit të fushës civile			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Hartimi i legjislacionit në fushën e të drejtave pronësore	2018-2020	DIEKP,DL	ZKM, MMPH, Agjen. Privatizimit, AKP, MAPL	Projekti i USAID/Programi për të Drejtat Pronësore
2	Hartimi i Kodit Civil të Republikës së Kosovës	2018-2019	DL	UP, KGJK, Oda e Noterëve, Oda e Përmbauesve e Privat, OAK, etj;	650,000 nga Projekti IPA "Hartimi i Kodit Civil, faza e II"
3	Ngritja e kapaciteteve të stafit të gjykatave, Noterisë, Përmbaimit Privat, OAK pas miratimit të Kodit Civil	2019	MD, DPL DL	Akademia e Drejtësisë, KGJK, Oda e Noterëve, Oda e Përmbauesve e Privat, OAK, etj.	Projekti IPA "Hartimi i Kodit Civil, faza e II"
4	Hartimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën civile	2021	DL	ZKM, KGJK, Oda e Noterëve, Oda e Përmbauesve e Privat, OAK, etj	Projekti IPA "Hartimi i Kodit Civil, faza e II"

OBJEKTIVA E DYTË STRATEGJIKE

Avancimi i ndihmës dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar

Masa 2.1		Përmirësimi i kornizës ligjore për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Zhvillimi i negociatave me shtetet me të cilat Republika e Kosovës ka interes reciprok	2018-21	DBJN	MPJ	BKK dhe partnerët ndërkombëtarë
2	Hartimi dhe dërgimi i Propozim Marrëveshjeve, me shtetet me të cilat Republika e Kosovës ka interes reciprok	2018-21	DBJN	MPJ	BKK

Masa 2.2		Intensifikimi i bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile dhe penale			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të marrëveshjeve	2018-2021	DBJN	KGJK/KPK/MPJ	BKK
2	Ngritja e bashkëpunimit me institucionet relevante	2018-21	DBJN	KGJK/KPK/PK/MPJ	BKK

Masa 2.3		Aderimi në mekanizma rajonal dhe ndërkombëtarë			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Inicimi i procedurave për aderim në Konventat e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private	2018-21	MD/DBJN	MPJ	Partnerët ndërkombëtarë
2	Ndërmarrja e veprimeve konkrete për anëtarësimin në	2018-21	MD/DIEKP	MPJ	Partnerët ndërkombëtarë

	organizata/nisma ndërkombëtare, rajonale (IDLO ⁷ , RAI ⁸ , etj.)				
3	Vendosja dhe fuqizimi i bashkëpunimit me EUROJUST ⁹	2018-21	MD	KPK, MPJ	Përmes projekteve të financuara nga BE (Bilaterale dhe Multilaterale)

Masa 2.4		Ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit të DBJN dhe aktorëve tjerë relevant			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Insttit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Ngritja e kapaciteteve profesionale në DBJN	2018-2021	DBJN	Akademia/KG JK/KPK	BKK dhe donatorët
2	Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta, me aktorët relevant, lidhur me fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar	2018-21	DBJN	Akademia/KG JK/KPK	Partneret donatorët

Masa 2.5		Digjitalizimi i Arkives në DBJN			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Insttit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Përditësimi i aplikacionit të DBJN	2018-2021	DBJN	MAP	BKK
2	Pajisja me aparaturë përkrahëse teknike	2018-21	DBJN	MAP	BKK/Donatorë

⁷ IDLO – Organizata Ndërkombëtare për Zhvillimin e së Drejtës

⁸ RAI - Iniciativën Rajonale Kundër Korrupsionit

⁹ EUROJUST - Njësia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim Gjyqësor

OBJEKTIVA E TRETË STRATEGJIKE

Administrimi më efikas i sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale

Masa 3.1	Ngritja e kapaciteteve teknike, profesionale të personelit te institucionet Korrektuese për trajtimin e të burgosurve në përputhje me instrumentet ndërkombëtare				
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi	
1	2018	SHKK	ZKM, MF, MZhe, MPMS, MBZhR	BKK dhe Donatorët, në veçanti Projekti i Binjakëzimit “Fuqizimi i mëtutjeshëm i Shërbimit Korrektues”	
2	2018	SHKK	KGJK, AKSP	Donatorët, në veçanti Projekti i Binjakëzimit “Fuqizimi i mëtutjeshëm i Shërbimit Korrektues”	
3	2021	SHKK	AKSP, MASHT	Donatorët, në veçanti Projekti i Binjakëzimit “Fuqizimi i mëtutjeshëm i Shërbimit Korrektues”	
4	2018	SHKK	MAP	Projekti i Binjakëzimit “Fuqizimi i mëtutjeshëm i Shërbimit Korrektues”	
5	2018-19	SHKK	MAP, MF	Projekti i Binjakëzimit “Fuqizimi i mëtutjeshëm i Shërbimit Korrektues”	
6	2019	SHKK/SHSK, Inspektoriati dhe DL	ZKM, KGJK, KPK, PK, MPB	UNICEF dhe Projekti i Binjakëzimit “Fuqizimi i mëtutjeshëm i	

7	Ofrimi i programeve rehabilituese dhe risocializuese për të burgosur	2018-21	SHKK	MPB, MPMS, MSh, MASHT	<i>Shërbimit Korrektues</i> Donatorët, në veçanti Projekti i Binjakëzimit “ <i>Fuqizimi i mëtutjeshëm i Shërbimit Korrektues</i> ”
8	Zgjerimi i hapësirave të punës për Drejtorinë Qendrore të SHKK	2018-21	MD	MAP	BKK

Masa 3.2		Ngritja e nivelit të sigurisë në institucionet korrektuese si dhe parandalimi dhe luftimi i dukurive negative në Institucionet Korrektuese			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Furnizimi dhe instalimi me pajisje teknike për siguri	2018-21	SHKK	MF, MPB, MAP	BKK/ Donatorë
2	Rekrutimi dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të zyrtareve sprovues dhe korrektues	2018	SHKK	MAP	BKK

Masa 3.3		Fuqizimi i Shërbimit Sprovues për ngritjen e kapaciteteve profesionale për zbatimin e masave dhe dënimeve alternative (MDA)			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Ngritja e kapaciteteve të SHSK-së për mbikëqyrjen e MDA-së	2018	SHSK	AKSP	Donatorët, në veçanti Projekti i Binjakëzimit “ <i>Fuqizimi i mëtutjeshëm i Shërbimit Korrektues</i> ”
2	Vetëdijesimi i opinionit profesional për dhënien e MDA-së	2018-21	SHSK	KGJK, KPK	Donatorët, në veçanti Projekti i Binjakëzimit “ <i>Fuqizimi i mëtutjeshëm i Shërbimit Korrektues</i> ”
3	Ristrukturimi i brendshëm i SHSK-së	2018-19	SHSK	MAP	BKK

Masa 3.4		Fuqizimi i Inspektoratit të MD-se për SHKK-ne			
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Insttit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi	
1	Profilizimi i inspektoreve në fusha specifike	2018	IMD	MAP	BKK/Donatorë
2	Ngritja e kapaciteteve profesionale të inspektoratit	2018-19	IMD	AKSP	Projekti i Binjakëzimit “Fuqizimi i mëtutjeshëm i Shërbimit Korrektues”

OBJEKTIVA E KATËRT STRATEGJIKE

Fuqizimi i kapaciteteve të mjekësisë ligjore dhe hulumtimi i krimeve të luftës

Masa 4.1		Funksionalizimi i plotë i Institutit të Mjekësisë Ligjore			
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Insttit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi	
1	Zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm të IML-së	2018	MD	MAP	BKK
2	Hartimi i akteve nënligjore	2018	IML-DL		projekti i IPA II

Masa 4.2		Masa 4.2 Ngritja e kapaciteteve profesionale në fushën e Mjekësisë Ligjore			
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Insttit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi	
1	Ngritja dhe Edukimi i vazhdueshëm profesional	2018-21	IML	MSH	Donatorë në veçanti projekti i IPA “Fuqizimi dhe Modernizimi i Shërbimeve të Mjekësisë Ligjore

					<i>në Kosovë. Faza e II'</i>
2	Digjitalizimi i data bazës së përgjithshme të IML-së	2018-21	IML	MAP	Donatorë

Masa 4.3		Masa 4.3 Avancimi i shërbimeve laboratorike mjekoligjore			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Themelimi i shërbimeve të reja laboratorike mjekoligjore	2018-21	IML	MSh, MASHT	BKK/Donatorë
2	Akreditimi i shërbimeve laboratorike Mjekoligjore	2018-21	IML	MSh, MASHT	BKK/Donatorë

Masa 4.4		Rritja e efikasitetit në trajtimin e rasteve të personave të pagjetur			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Funksionalizimi dhe menaxhimi i AM/PM data bazës	2018-21	IML	MAP	BKK/Donatorë
2	Trajtimi i mbetjeve mortore ekzistuese dhe artefakteve	2018-21	IML	KQPZh	BKK/Donatorë
3	Mbështetje psiko-sociale për familjaret e personave të pagjetur	2018-21	IML	MSh	BKK

Masa 4.5		Fuqizimi i bashkëpunimit në fushën e mjekësisë ligjore			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Fuqizimi i bashkëpunimit me organet e rendit dhe forenzike	2018-21	IML	KPK, MPB, PK	BKK/Donatorë
2	Bashkëpunimi me institucionet e përfshira në çështjen e rasteve të personave të zhdukur	2018-21	IML	KQPZh	BKK/Donatorë

3	Bashkëpunimi me institutet relevante rajonale dhe ndërkombëtare	2018-2021	IML	MPB/MPJ	BKK/Donatorë
---	---	-----------	-----	---------	--------------

Masa 4.6		Ristrukturimi i mekanizmit për hulumtimin e krimeve të luftës			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Themelimi Departamentit për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit	2018	MD	ZKM, MF, MAP	BKK
2	Krijimi i një data bazë për dokumentimin e krimeve të luftës dhe të dëmeve të luftës	2018-21	MD	MAP, MF	BKK

OBJEKTIVA E PESTË STRATEGJIKE

Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për funksionim efikas në fushën e drejtësisë

Masa 5.1		Funksionalizimi i plotë i Avokaturës Shtetërore dhe krijimi i njësisë së veçantë për çështje të arbitrazhit			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kosto
1	Organizimi i brendshëm i ASH	2018	ASH	MAP	BKK
2	Rritja e numrit të avokateve shtetëror	2018-21	ASH	MAP	BKK
3	Ngritja e kapaciteteve profesionale të avokateve shtetëror	2018-21	ASH		Projekti i IPA "Mbështetje të profesioneve të lira dhe Odes së Avokateve"
4	Ngritja e kapaciteteve profesionale për lëndët e arbitrazhit	2018-21	ASH		Projekti i IPA "Mbështetje të profesioneve të lira dhe Odes së Avokateve"
5	Zgjerimi i hapësirave të punës për ASH	2018-21	MD	MAP	BKK

Masa 5.2		Avancimi i sistemit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kosto
1	Ngritja e kapaciteteve profesionale në AAPSK	2018-2021	AAPSK	AKSP, KPK, KGJK, PK,	BKK dhe Projekti i IPA “Mbështetje e mëtejme për institucionet e Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit”
2	Zgjerimi i hapësirave të depot ekzistuese	2018-2019	AAPSK	MAP, MF	BKK
3	Rritja e numrit të stafit të AAPSK	2018	MD	MAP	BKK
4	Krijimi i një “fondi” të konfiskimit	2018-2019	MD-MF		BKK
5	Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta për fushën e konfiskimit/sekuestrimit të pasurisë me aktorët relevant	2018-2021	AAPSK	KPK, KGJK, PK,	BKK dhe Projekti i IPA “Mbështetje e mëtejme për institucionet e Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit”
6	Avancimi i sistemit të ruajtjes së vlerës së pasurisë përmes shitjes në fazën e sekuestrimit	2018-2021	AAPSK	KPK, KGJK, PK,	BKK

Masa 5.3		Forcimi i mekanizmit mbikëqyrjes së profesioneve të lira me qëllim të funksionimit të mirëfilltë të mbikëqyrjes së profesioneve të lira			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Instit. e ndërlidhur	Kosto
1	Krijimi i një Divizioni për mbikëqyrje administrative dhe mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së Profesioneve të Lira	2018-21	DPL	MAP	BKK

2	Ngritja e kapaciteteve profesionale për fushën specifike	2018-21	DPL	Akademia e Drejtësisë	BKK/Donatorë
---	--	---------	-----	-----------------------	--------------

Masa 5.4		Përmirësimi i kornizës ligjore për profesionet e lira dhe avancimi i funksionalizimit të profesioneve të lira			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Insttit. e ndërlidhur	Kostot dhe burimi
1	Reformimi i sistemit të provimit të jurisprudencës	2018-21	MD/DPL	UP, KGJK, KPK, OAK	Donatorë në veçanti projekti IPA “Mbështetje profesioneve të lira ligjore dhe odës së avokatëve në Kosovë”
2	Inicimi i Qasjes ne regjistrat civil	2018	DPL	MAP, BQK, MPB	BKK
3	Vetëdijesimi i opinionit publik për profesione te lira	2018-21	DPL	KGJK, KPK, OAK, BQK	Donatorë në veçanti projekti IPA “Mbështetje profesioneve të lira ligjore dhe odës së avokatëve në Kosovë”
4	Funksionalizimi i plotë i sistemit noterial sipas legjislacionit të ri	2018-2021	DPL	Oda e noterëve	BKK
5	Rritja e numrit të përmbauesve privat	2018-2021	DPL	Oda e Përmbauesve Privat	BKK

Masat 5.5		Avancimi i mbështetjes tekniko-administrative për njësitë e brendshme te MD			
	Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Insttit. e ndërlidhur	Kosto
1	Avancimi i mekanizmave dhe përgatitja e stafit për Marrëdhënie Publike dhe Protokollare në MD	2018-19	DFShP, DIEKP	MPJ	Donatorë

2	Rregullimi i hapësirës dhe sigurimi i pajisjeve teknike për përkthime	2018-19	DFShP	MAP	BKK
3	Sigurimi i pajisjeve teknike për organizimin e Video-konferencave në MD	2018-19	DFShP	MAP	BKK/Donatorë

